



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

## PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2025

PËR

### “PROGRAMIMIN E INSPEKTIMEVE, METODOLOGJINË E VLERËSIMIT TË RISKUT, PËRCAKTIMIN E PERIUDHËS MAKSIMALE TË INSPEKTIMEVE VJETORE DHE MËNYRËN E LLOGARITJES SË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 32 pika 8, nenit 34, të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

#### I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

- Ky vendim ka për qëllim krijimin e kuadrit rregulator të përgjithshëm për programimin e inspektimeve, metodologjinë e vlerësimit të riskut në veprimtarinë inspektuese, përcaktimin e periudhës maksimale të lejuar të inspektive vjetore, për çdo kategori të subjekteve të inspektimit.
- Ky vendim është i zbatueshëm nga Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore dhe vendore, të përcaktuara sipas dispozitave në fuqi të ligjit për inspektimin.

#### II. PËRKUFIZIME

1. “Sektor inspektimi”, është zona/fusha e veprimit tematik, në bazë të kompetencave ligjore të inspektorateve, mbi të cilën ushtrohet funksioni i inspektimit, ku vlerësohet zbatimi i legjislacionit në fuqi, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjit, rregulloreve dhe standardeve përkatëse;
2. “Subjekt inspektimi”, është çdo person juridik dhe fizik, publik apo privat, ndaj të cilit ushtrohet inspektimi për të verifikuar zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe standardeve përkatëse në një fushë të caktuar, të identifikuar nga çdo inspektorat;
3. “Objekt inspektimi”, është **veprimtaria**, procesi, dokumentacioni, sendi apo një veprim specifik e konkret, që është në fokus të kontrollit dhe vlerësimit gjatë një inspektimi, për çdo fushë inspektimi;
4. “Gjasat për papërputhshmëri”, janë niveli i pritshëm i rezikut që një subjekt, sektor apo veprimtari, mund të paraqesë në drejtim të mosrespektimit të kërkesave ligjore dhe rregullatore. Vlerësimi i këtyre gjasave ndihmon në përcaktimin e prioriteteve në programimin mbi bazë risku të inspektimit;
5. “Efektet për papërputhshmëri”, janë pasojat negative që mund të rezultojnë nga mosrespektimi i kërkesave ligjore, rregullatore apo standardeve përkatëse, nga një subjekt apo sektor inspektimi;
6. “Faktor risku”, është një element, rrethanë ose karakteristikë që ndikon në nivelin e rezikut për papërputhshmëri me legjislacionin, rregulloret apo standarde përkatëse, që ndikon në nivelin e rezikut për të vlerësuar probabilitetin dhe **ndikimin e papërputhshmërisë** për të përcaktuar prioritetet e programimit të inspektimit;
7. “Sistem pikëzimi”, është mbledhja e vlerës së treguesve për secilin faktor në një shumatore të përgjithshme;
8. “Tregues të faktorëve të riskut”, janë **elementë** të matshëm, specifikë dhe të verifikueshëm që përdoren për të identifikuar dhe vlerësuar praninë dhe nivelin e një faktori risku;
9. “Matrica e vlerësimit të riskut”, është një mjet analistik që përdoret për të vlerësuar dhe kategorizuar nivelet e riskut për **subjektet e inspektimit**, duke kombinuar gjasat e papërputhshmërisë me efektet e mundshme që ato mund të shkaktojnë. Matrica është një mjet e cila lejon një përbledhje të qartë **dhe** vizuale të rezikut që ndihmon në programimin e veprimtarisë inspektuese.

### III. RREGULLAT E PËRGJITHSHME BAZË TË PROGRAMIMIT TË INSPEKTIMIT

1. Veprimtaria inspektuese e inspektorateve qendrore dhe vendore bazohet në programin vjetor dhe mëjor të inspektimit. Programi i inspektimeve është mjeti që përdor inspektorati qendror dhe vendor për planifikimin e inspektimeve në subjektet, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën përkatëse të inspektimit.
2. Inspektoratet qendrore dhe vendore **hartojnë** program vjetor dhe mëjor të inspektimit.
3. Programi vjetor i inspektimit të inspektorateve qendrore është plani i detajuar mbi bazë tematike, mbështetur në metodologjitet e vlerësimit të riskut, si dhë prioriteteve dhe politikave të fushës përkatëse të inspektimit mbështetur në politikat e ministrisë përgjegjëse.

4. Programi mujor i inspektimit i inspektoratit qendorr është i detajuar me subjekte inspektimi, i mbështetur në metodologjitet e vlerësimit të riskut dhe në detyrimin ligjor për inspektimin periodik të subjekteve të inspektimit.
5. Inspektorati i Përgjithshëm, jep mendim këshillimor për programin vjetor të inspektimit dhe miratohet nga ministria përgjegjëse.
6. Inspektorati i Përgjithshëm, miraton programin mujor të inspektimit, të hartuar nga inspektorati qendorr ose strukturat e tjera inspektuese.
7. Programi vjetor i inspektimit të inspektoratit vendor hartohet nga inspektorati vendor dhe miratohet nga kryetari i bashkisë, pas dhënies së mendimit këshillimor nga Inspektorati i Përgjithshëm.
8. Programi mujor i inspektimit për çdo inspektorat vendor hartohet nga inspektoratet përkatëse vendore dhe i dërgohet për mendim Inspektoratit të Përgjithshëm.
9. Inspektorati i Përgjithshëm mbikëqyr zbatimin e programeve vjetore dhe mujore pas miratimit të tyre sipas kërkesave ligjore.
10. Në miratimin e programeve mujore sipas përcaktimit në pikën 6 dhe dhënien e mendimit këshillimor sipas përcaktimit në pikat 5, 7 dhe 8 të këtij Kreu, Inspektorati i Përgjithshëm synon të shhang mbivendosjen e trupave inspektuese në inspektime, përsëritjen e inspektimeve pa shkak të arsyetuar, koordinimin midis inspektimeve qendrore dhe inspektimeve vendore.
11. Inspektorati i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë të gjithë informacionin e nevojshëm për veprimtarinë e inspektorateve qendrore dhe vendore të lidhur me programimin e veprimtarisë së inspektimit.

#### IV. PROCEDURA E PROGRAMIMIT TË VEPRIMTARISË INSPEKTUESE MBI BAZË RISKU

1. Programi vjetor i inspektimi, për inspektoratet qendrore, hartohet mbi bazë tematike, mbështetur në metodologjitet e vlerësimit të riskut, si dhe prioriteteve dhe politikave të ministrisë përgjegjëse, e objektivave vjetorë, afatmesëm dhe strategjikë të inspektoratit qendorr.
2. Inspektorati qendorr apo vendor i paraqet respektivisht, ministrit përgjegjës apo kryetarit të bashkisë, si dhe Inspektorit të Përgjithshëm, brenda datës 15 Tetor të vitit paraardhës, programin vjetor tematik të inspektimit, të hartuar edhe në përputhje me metodologjinë e sistemit online të inspektimeve.
3. Inspektorati i Përgjithshëm jep mendim këshillimor për programin vjetor të inspektimit për inspektoratet qendrore dhe vendore brenda 5 (pesë) ditëve pune.
4. Inspektoratet qendrore dhe vendore reflektojnë mendimin këshillimor të dhënë nga Inspektorati Përgjithshëm, në rast të kundërt, duhet të kthejnë përgjigje të motivuar.
5. Programi vjetor i inspektimit, pas miratimit të ministrit përgjegjës apo kryetarit të bashkisë përkatës, gjenerohet në sistemin online të inspektimeve, nga inspektorati qendorr apo vendor, brenda datës 5 dhjetor të vitit paraardhës.
6. Pikat 2 deri 5, të këtij kreu, janë të zbatueshme edhe për programin vjetor të monitorimit dhe

kontrollit zyrtar.

7. Inspektorati qendror harton programin **mujor** dhe e dërgon për miratim pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, brenda datës 10 të muajit paraardhës.
8. Inspektorati i Përgjithshëm miraton programin **mujor** të inspektimit, të inspektoratit qendror brenda datës 20 të muajit paraardhës, mbështetur në metodologjitet e vlerësimit të riskut.
9. Inspektorati Qendror gjeneron programin **mujor** të inspektimit në sistemin online të inspektimeve brenda datës 25 të muajit paraardhës.
10. Programi **mujor** i inspektimit, për çdo inspektorat vendor, hartohet nga inspektorati përkatës dhe i dërgohet për mendim Inspektoratit të Përgjithshëm, brenda datës 10 të muajit paraardhës. Inspektorati vendor e gjeneron programin **mujor** të inspektimit brenda datës 25 të muajit paraardhës.
11. Në rast se një subjekt inspektimi është **programuar** nga dy o më shumë inspektorate, sistemi identifikon inspektoratet qendrore dhe vendore që e kanë **programuar**. Inspektorati i Përgjithshëm, cakton afatin kohor të përbashkët për fillimin e procedurës së inspektimit dhe njofton inspektoratet përkatëse. Afati kohor i përbashkët për fillimin e procedurës së inspektimit është i detyrueshëm për inspektoratet përgjegjëse.
12. Inspektorati i Përgjithshëm në bashkëpunim me inspektoratet qendrore dhe vendore harton treguesit për gjenerimin e programit vjetor dhe **mujor** të inspektimeve, në sistem dhe i rishikon ato në mënyrë periodike.
13. Inspektoratet qendrore dhe vendore kryejnë, sipas parashikimeve ligjore, inspektime jashtë programit të inspektimit, por në përputhje me ligjin për inspektimin dhe bëhen pjesë e sistemit online të inspektimit.
14. Numri i inspektimeve të kryera jashtë programit nuk duhet të kalojë masën 25 % të numrit të inspektimeve të përcaktuar në programin **vjetor** të inspektimit, me synim uljen e kësaj mase nga viti në vit.
15. Inspektorati qendror apo vendor, përfshihet në veprimtari inspektuese në kuadër *task-force*, të cilat janë pjesë e inspektimeve jashtë programit të inspektimit. Në çdo rast të pjesëmarrjes në *task force*, procedura e inspektimit kryhen nga trupat e inspektorateve qendrore dhe vendore, sipas dispozitive të ligjit per inspektimin. Në këto raste, programi i *task-force*s miratohet nga Inspektorati i Përgjithshëm.
16. Inspektorati i Përgjithshëm përshtat metodologjinë e programimit vjetor të veprimitarisë së inspektimit për inspektoratet qendrore dhe vendore në sistemin elektronik të inspektimeve, për inspektimet e programuara dhe inspektimet jashtë programit. Programi vjetor i inspektimeve, në vlera sasiore, bëhet sipas metodologjisë së përcaktuar në sistemin online të inspektimeve.

## V. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR PROGRAMIMIN E VEPRIMTARISË INSPEKTUESE

1. Vlerësimi i riskut në veprimtarinë **inspektuese** është një procedurë sistematike dhe e vazhdueshme e inspektorateve qendrore dhe vendore, e cila ka për qëllim shqyrtimin, identifikimin, përcaktimin dhe kategorizimin e sektorëve, subjekteve dhe objekteve të

inspektimit në bazë të riskut që ato prodrojnë ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.

2. Inspektoratet qendrore dhe vendore, krijojnë një bazë të dhënash për sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit në fushën e tyre të veprimit, ku ushtrojnë funksione inspektimi, sipas modulit të subjekteve të inspektimit në sistemin online të inspektimit.
3. Inspektorati i Përgjithshëm krijon një bazë të dhënash të qendërzuar, me profile individuale të subjekteve të inspektimit, në bazë të dhënavë të grumbulluara nga inspektoratet qendrore dhe vendore, sipas pikës 2, të këtij Kreu, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të inspektimeve, në bazë të ligjit për inspektimin. Kjo bazë të dhënash të qendërzuara është pjesë e sistemit elektronik të inspektimit.
4. Baza e të dhënavë të inspektorateve qendrore dhe vendore, pjesë e sistemit elektronik të inspektimeve, përmban informacion mbi riskun e përgjithshëm, në fushën e veprimit të inspektorateve qendrore dhe vendore, që gjenerohet nga:
  - a) sektorët e inspektimit në fushën e veprimtarisë së tyre;
  - b) subjektet e inspektimit të identifikuara nga çdo inspektorat;
  - c) objektet e inspektimit për çdo fushë inspektimi.
5. Inspektorati i Përgjithshëm, nëpërmjet sistemit elektronik të inspektimit, përpunon informacionin e mbledhur rrëth subjekteve të inspektimit dhe kategorizon këto subjekte për renditjen e tyre sipas vlerësimit të riskut të shprehur nëpërmjet treguesve individualë të riskut.

## VI. FAKTORËT E RISKUT PËR VLERËSIMIN E SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT

1. Inspektoratet qendrore përcaktojnë treguesit dhe faktorët e riskut të sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit, në bashkëpunim me ekspertë të fushës së tyre të inspektimit, si dhe duke marrë si standard praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Bordi i inspektimeve miraton treguesit dhe faktorët e riskut të hartuara nga inspektoratet qendrore dhe vendore, si dhe treguesit e përbledhur të hartuar nga Inspektorati i Përgjithshëm dhe më pas ato hidhen në sistemin elektronik të inspektimeve.
3. Faktorët e riskut ndahen në faktorë **risku** të lidhur me gjasat për papërputhshmëri dhe në faktorë **risku** të lidhur me efektin e papërputhshmërisë.
4. Gjasat për papërputhshmëri, lidhen me historikun e përputhshmërisë dhe shprehin tendencën e sektorëve dhe subjekteve të inspektimit ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.
5. Efekti i papërputhshmërisë, lidhet me dëmin dhe lëndimin që do të shkaktohej në rast papërputhshmërie dhe shpreh ndikimin e sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.
6. Faktorët e riskut të lidhur me gjasat për papërputhshmëri përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të ndryshimeve të kërkësave ligjore për t'u respektuar nga sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit, si dhe tendencës që shfaqet për pa përputhshmëri me to nga subjektet e inspektimit, pas çdo inspektimi të kryer.
7. Faktorët e riskut të lidhur me efektin e papërputhshmërisë përditësohen në mënyrë të

vazhdueshme, në bazë të evidencave të reja mbi ndikimin e sektorëve dhe subjekteve ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridike.

8. Treguesit e faktorëve të riskut **shprehin** në mënyrë sasiore dhe/ose cilësore peshën e riskut brenda të njëjtë faktor riskut dhe ndërmjet faktorëve të ndryshëm të riskut.
9. Treguesit e faktorëve të riskut **agregohen** në një shumatore të përgjithshme për të gjithë faktorët e riskut.
10. Pesha specifike e treguesve të faktorëve të riskut përditësohen në bazë të prioriteteve të inspektorateve qendrore dhe vendore, si dhe historikut të inspektimeve të sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit.

## VII. PËRCAKTIMI I RISKUT TË PËRGJITHSHËM PËR VLERËSIMIN E SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT

1. Risku i përgjithshëm i efektit për papërputhshmëri për çdo subjekt inspektimi përbëhet nga tre treguesit e mëposhtëm:
  - a. Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut të lidhur me gjasat për papërputhshmëri dhe efektin e papërputhshmërisë të sektorëve të inspektimit aggregohen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për çdo sektor inspektimi (Risku i Sektorit).
  - b. Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut, të lidhur me efektin e papërputhshmërisë të objekteve të inspektimit aggregohen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për çdo objekt inspektimi (Risku i Objekteve).
  - c. Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut të lidhur me gjasat për papërputhshmëri të subjekteve të inspektimit aggregohen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për gjasat për pa-përputhshmëri për çdo subjekt inspektimi (Risku i Gjasave për Papërputhshmëri).
2. Treguesit (vlerat) e faktorëve të efektit për papërputhshmëri të subjekteve të inspektimit, Risku i Sektorit (vlera sipas pikës 1/a, të këtij kapitulli) dhe Risku i Objektit (vlera sipas pikës 1/b të këtij kapitulli) me të cilin/ët subjekti i inspektimit është i lidhur, aggregohen në një shumatore të përgjithshme duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për efektin e papërputhshmërisë për çdo subjekt inspektimi (Risku i Efektit të Papërputhshmërisë).
3. Inspektorati i Përgjithshëm harton **dhe** miraton në Bordin e inspektimeve platformën elektronike të programimit të inspektimeve mbi bazë të vlerësimit të riskut, e cila bëhet pjesë e sistemit elektronik të inspektimeve **dhe** realizon renditjen e subjekteve të inspektimit, sipas fushave dhe sektorëve të inspektimit, si dhe bën të mundur programimin e inspektimeve me bazë risku.

## VIII. PLATFORMA ELEKTRONIKE E INSPEKTIMEVE MBI BAZË TË VLERËSIMIT TË

## RISKUT

1. Platforma elektronike e inspektimeve përmban të gjitha algoritmet e integruara, sipas Matricës së Vlerësimit të Riskut dhe metodologjisë së sistemit elektronik të inspektimeve, sipas Aneksit I, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Inspektoratet qendrore dhe vendore, në bashkëpunim me ekspertë të fushës së tyre të inspektimit dhe duke marrë si standard praktikat më të mira kombëtare e ndërkombëtare, përcaktojnë pesë intervalle klasifikimi të vlerave të treguesve të përgjithshëm të riskut të gjasave për papërputhshmëri dhe riskut të efektit për papërputhshmëri, për t'ju përshtatur vlerave përkatëse të riskut të matricës së vlerësimit të riskut në ambientin sistemit elektronik të inspektimeve.
3. inspektoratet qendrore dhe vendore përditësojnë dhe publikojnë në sistemin elektronik të inspektimeve, si dhe në faqen e tyre zyrtare, faktorët e gjasave për papërputhshmëri dhe faktorët e efektit për papërputhshmëri, peshën dhe treguesit e tyre, në mënyrë që subjektet e inspektimit të ndërgjegjësohen dhe të pozicionohen qartë për ndikimin e tyre ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë, si dhe për tendencën që duhet të kenë në respektimin e kërkesave ligjore.
4. Inspektoratet qendrore dhe vendore hedhin të dhënat për riskun në Matricën e Vlerësimit të Riskut në mënyrë periodike ose në vazhdimësi, në varësi të specifikave të inspektoratit përkatës dhe ndryshimit të kërkesave ligjore.
5. Kryeinspektori qendror apo vendor, autorizon nëpunësin përgjegjës, të ndryshëm nga ata që ushtrojnë funksione inspektuese, për përcaktimin e faktorëve të riskut, peshës dhe treguesve të tyre, me mbështetjen e ekspertëve të fushës së tyre të inspektimit.
6. kryeinspektori qendror apo vendor, autorizon nëpunësit përgjegjës, të ndryshëm nga ata që ushtrojnë funksione inspektuese, për hedhjen dhe monitorimin e vlerave të riskut të gjasave për pa përputhshmëri dhe të riskut të efektit të pa përputhshmërisë për subjektet e inspektimit, në sistemin elektronik të inspektimeve, për menaxhimin e riskut.

## IX. PERIUDHA MAKSIMALE E LEJUAR E INSPEKTIMEVE VJETORE, PËR ÇDO KATEGORI TË SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT

1. Programimi i inspektimeve mbështetet edhe në periudhën maksimale të lejuar të qëndrimit në subjektin e inspektimit.
2. Periudha maksimale e lejuar e inspektimeve vjetore, për çdo kategori të subjekteve të inspektimit, për veprimtarinë e të gjithë inspektoratet qendrore, përcaktohet në varësi të:
  - a) madhësisë së subjektit të inspektimit;
  - b) rrezikut të veprimtarisë që kryhen subjekti i inspektimit.
3. Në përcaktimin e periudhës së inspektimit, inspektorati qendror përgjegjës, duhet të parashikojë të gjithë faktorët që mundësojnë funksionimin e subjektit, i cili do të inspektohet, si dhe çdo element që bën të mundur ushtrimin e aktivitetin, si:
  - a) kategorinë tatimore ku bën pjesë subjekti i inspektimit, sipas kategorizimit që përcakton ligji për procedurat tatimore (xhiron vjetore);

- b) lloji i licencës për ushtrim veprimtarie në fushën përkatëse (kategorizime sipas QKB).
  - c) sasinë e prodhimit ose të produkteve që hedh në treg (në rast shoqëri import-eksport) dhe ndikimin që ka kjo sasi në tregun e konsumit;
  - d) karakteristikat specifike të aktivitetit të subjektit të inspektimit;
  - e) rrezikshmërinë që mund të vijë nga ushtrimi i aktivitetit të atij subjekti;
4. Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor, është 5 deri në 15 ditë maksimalisht, në varësi të karakteristikave të përcaktuara në pikën 2 dhe 3, të këtij Kreu.
  5. Inspektorati i përgjithshëm bën ndërveprimin me sisteme të tjera elektronike që përbajnjë të dhënat sipas pikës 2 dhe 3, të këtij Kreu, nëpërmjet sistemit elektronik të inspektimeve.
  6. Inspektorati qendror përgjegjës për programimin e inspektimit, përcakton kohën e qëndrimit në subjekt, në varësi edhe të përcaktimeve ligjore për periodicitetin e vizitave inspektuese në subjekt, si dhe kohëzgjatjen e një procedure inspektuese në subjekt, për programimin e inspektimeve pranë subjektit të inspektimit, mbështetur në kriteret e parashikuara në pikën 2 dhe 3, të këtij Kreu.
  7. Inspektorati i Përgjithshëm krijon një bazë të dhënash për subjektet e inspektimit të kategorizuara sipas kritereve të parashikuara në pikën 2 dhe 3, të këtij Kreu, në bazë të kategorizimit të bërë nga inspektoratet qendrore përkatëse.
  8. Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor, e ndarë sipas kategorive të subjekteve të inspektimit, të jetë si më poshtë:
    - a) Për subjektin e inspektimit, që sipas kritereve të parashikuara në pikën 2 dhe 3, të këtij Kreu, është përcaktuar kategoria shumë e lartë, mbi praktikat normale të konstatuara në vazhdimësi, kohëzgjatja kohore e inspektimit, të jetë nga 13 ditë deri në afatin maksimal prej 15 ditësh.
    - b) Për subjektin e inspektimit, që sipas kritereve të parashikuara në pikën 2 dhe 3, të këtij Kreu, është përcaktuar kategoria e lartë, mbi praktikat normale të konstatuara në vazhdimësi, kohëzgjatja kohore e inspektimit, të jetë nga 9 ditë deri në afatin maksimal prej 12 ditësh.
    - c) Për subjektin e inspektimit, që sipas kritereve të parashikuara në pikën 2 dhe 3, të këtij Kreu, është përcaktuar kategoria e mesme, mbi praktikat normale të konstatuara në vazhdimësi, kohëzgjatja kohore e inspektimit, të jetë 7 ditë deri në afatin maksimal prej 8 ditësh.
    - d) Për subjektin e inspektimit, që sipas kritereve të parashikuara në pikën 2 dhe 3, të këtij Kreu, është përcaktuar kategoria e ulët, mbi praktikat normale të konstatuara në vazhdimësi, kohëzgjatja kohore e inspektimit, të jetë minimumi 5 deri në afatin maksimal prej 6 ditësh.
  9. Inspektoratet qendrore dhe vendore përcaktojnë kohëzgjatjen e qëndrimit në subjektet e inspektimit, sipas kategorive të tyre, në bazë të përcaktimeve të pikës 8, të këtij Kreu.
  10. Në sistemin elektronik të inspektimeve, kategorizimi i subjekteve, sipas këtij Kreu, rishikohet dhe përditësohet në bazë të dhënavë të shkëmbyera me sisteme të tjera elektronike qeveritare, si dhe të dhënavë të subjekteve të inspektimet të kategorizuara në bazë risku nga vetë sistemi online i inspektimeve.
  11. Të gjitha të dhënat, mbi bazën e të cilave ndërtohet metodologja e analizës së vlerësimit të riskut për çdo inspektorat qendror, vendor apo strukturë tjetër inspektuese, gjenerohen në sistemin elektronik unik “e-Inspektimi”.

## X. DISPOZITA E FUNDIT

- Ngarkohen Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

## ANEKSI I: VLERËSIMI I RISKUT TË SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT

### I. MATRICA E VLERËSIMI TË RISKUT

- Vlerësimi i riskut në modulin e vlerësimit të riskut në sistemin elektronik të inspektimeve kryhet në bazë të matricës së vlerësimit të riskut, e cila kategorizon subjektet e inspektimit sipas sistemit të pikëzimit, më poshtë:

Efekti i papërput hshmërisë	Gjasat për papërputshmëri					
	+	1	2	3	4	5
	5	6	7	8	9	10

	<b>4</b>	5	<b>6</b>	7	8	<b>9</b>
	<b>3</b>	4	<b>5</b>	6	7	<b>8</b>
	<b>2</b>	3	<b>4</b>	5	6	<b>7</b>
	<b>1</b>	2	<b>3</b>	4	5	<b>6</b>

2. Kategoria e riskut përcaktohet nga vlera e Riskut të Përgjithshëm të subjektit të inspektimit që përfshin numrat e plotë në intervalin 2-10.
3. Vlera e Riskut të Përgjithshëm përcaktohet nga shuma e vlerës së Riskut të Gjasave për Papërputhshmëri dhe vlerës së Riskut të Efektit të Papërputhshmërisë.
4. Vlera e Riskut të Gjasave për Papërputhshmëri përfshin numrat e plotë në intervalin 1-5.
5. Vlera e Riskut të Efektit për Papërputhshmëri përfshin numrat e plotë në intervalin 1-5.
6. Në kuqtimin e kësaj matrice, Risku i Përgjithshëm, Risku i Gjasave për Papërputhshmëri dhe Risku i Efektit për Papërputhshmëri mitten në varësi të rritjes së vlerës numerike, sipas:  
 2-3, i Ulët;  
 4-5, Moderuar;  
 6-7, i Mesem;  
 8-9, i Lartë;  
 9-10, Ekstrem.